



KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 02, datë 30.01.2020**

**Mbi rinovimin e kontratës me bankat agjente të përzgjedhura  
në listën paraprake për procesin e kompensimit**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 2, pika 4 dhe pika 5 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.07.2016, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23, datë 3.10.2017 “Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për kryerjen e procesit të kompensimit”, me propozim të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

**V E N D O S I:**

1. Të rinovojë për një periudhë 1 (një) vjeçare kontratën me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për kryerjen e procesit të kompensimit, si vijon:
  - Banka Kombëtare Tregtare SHA;
  - Banka Raiffeisen SHA;
  - Banka Intesa SanPaolo SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë bankat e përzgjedhura në listën paraprake, si dhe Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
3. Ngarkohet Sektori për Marrëdhëniet me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**